



Republika e Kosovës /
Komuna e Podujevës

Republika Kosova /
Opština Podujevo

Republic of Kosova
Municipality of Podujeva



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

Podujevë

Nr. 10-016/01-0005056/24

NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor, rregullorës komunale për transportin rrugor në territorin e komunës së Podujevës nr. 01-345/01-0008883/23 të datës 31 Janar 2023, rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taxi të udhëtarëve nr. 01-345/01-0008882/23 të datës 31 Janar 2023, vendimit për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano – periferike në vendbanimet rurale dhe orarin e qarkullimit nr. 01-345/01-0008885/23 të datës 31 Janar 2023, nenit 19 pika (1.14) dhe (1.6) të Statutit të Komunës së Podujevës, i miratuar me dt. 29 qeshor 2018.

Lajmërohen të gjithë operatorët të cilët ushtrojnë veprimatrinë e transportit të udhëtarëve në transportin urban, dhe urbano- periferik në vendbanimet rurale, duke përfshirë edhe Radio dhe Auto – Taxi, të cilët janë të pajisur me leje pune për vitin 2023:

Të aplikojnë për vazhdimin e lejeve të punës (rendit të udhëtimit) për vitin 2024 në linjat përkatëse.

Afati i aplikimit është deri me datën 02.02.2024

Dokumentacioni për aplikim merret dhe dorëzohet në zyrën për qytetarë.

Ndaj operatorëve të cilët nuk pajisen me vazhdimin e lejeve të punës (rendit të udhëtimit) do të merren masa ndëshkuese dhe parandaluese për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Podujevë
17.01.2024

